



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.471/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesuese, Afijete Sada - Glllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Levizja Vetvendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.02.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohen** të bazuara ankesat e evidentuara si: Anr.471/2021, Anr.472/2021, Anr.473/2021, Anr.474/2021, Anr.475/2021, Anr.479/2021, Anr.480/2021, Anr.481/2021, Anr.482/2021, Anr.483/2021, Anr.484/2021, Anr.485/2021, Anr.486/2021, Anr.487/2021, Anr.489/2021, Anr.490/2021, Anr.491/2021, Anr.492/2021, Anr.493/2021, Anr.494/2021, Anr.495/2021, Anr.496/2021, Anr.497/2021, Anr.498/2021 të gjitha të datës 14.02.2021, të paraqitura nga subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore përmes rrjeteve sociale, ndërsa subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, i shqiptohet dënim me gjobë, në lartësi prej 12,000.00 (dymbëdhjetëmijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të dënimit shtesë.

## A r s y e t i m

Me datë 14.02.2021, PZAP-i ka pranuar ankesat Anr.471/2021, Anr.472/2021, Anr.473/2021, Anr.474/2021, Anr.475/2021, Anr.479/2021, Anr.480/2021, Anr.481/2021, Anr.482/2021, Anr.483/2021, Anr.484/2021, Anr.485/2021, Anr.486/2021, Anr.487/2021, Anr.489/2021, Anr.490/2021, Anr.491/2021, Anr.492/2021, Anr.493/2021, Anr.494/2021, Anr.495/2021, Anr.496/2021, Anr.497/2021, Anr.498/2021, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, në të cilat pretendon me datë 13 dhe 14 shkurt 2021, Lëvizja Vetëvendosje, respektivisht kandidatët e LVV Jeta Statovci, Adnan Rustemi, Arberie Nagavci, Alban Bajrami, Fjolla Ujkani, Visar Koronica, Ekrem Mustafa, Sali Zyba, Drin Zariqi (mbështetës i LVV), Naser Beqiri (mbështetës i LVV), Kushtrim Ramadani (udhëheqës i pikës Dodona të LVV – Prishtinë), Fidan Bajrami (aktivist), Emin Sejani (aktivist), Dino Meta (aktivist), Ibrahim Ajupi (aktivist), Floren Ranqaj (aktivist), Fitim Pacolli (anëtar), Arbër Vrajolli (aktivist), Ardian Sopjani (aktivist), Shpëtim Xheladini (aktivist), Agron Hamiti (aktivist), Çlirim Gërbeshi (aktivist), Alban Lahu (anëtar), Behar Jashari (aktivist), kanë thyer heshtjen zgjedhore duke

bërë shpërndarjen dhe postimin e fotove dhe thirrjeve për të votuar LVV dhe kandidatët e saj për deputet në kundërshtim me legjislacionin e aplikueshëm. Pra thyerja e heshtjes zgjedhore sic vërehet nga provat e bashkangjitura është aktive edhe gjatë heshtjes zgjedhore, ku vërehet data dhe ora e saktë, fotot janë bërë sot dhe janë në kundërshtim me nenin 36 të LZP-së dhe nenit 8 të Rregullores Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së. në këtë rast është thyer heshtja zgjedhore.

Në përgjigjet në ankesë sa i përket ankesave Anr.471/2021, Anr.472/2021, Anr.473/2021, Anr.479/2021, Anr.480/2021, Anr.481/2021, Anr.483/2021, Anr.486/2021, Anr.487/2021, Anr.489/2021, Anr.494/2021, Anr.495/2021, Anr.496/2021, Anr.497/2021, Anr.498/2021, pretendon se nga shikimi i hollësishëm i veprimtarisë në facebook të kandidatëve dhe votuesve të sipër cekur, vërehet qartë se të gjitha postimet e kontestuar janë bërë gjatë fushatës, para se të fillonte heshtja zgjedhore, saktësisht me datë 12.02.2021 dhe 13.02.2021. heshtja zgjedhore ka filluar me 13 shkurt 2021, në orën 07:00 dhe ka përfunduar me 14 shkurt 2021. Të gjitha postimet e kontestuara nga ana e PDK-së, janë bërë gjatë fushatës, para se të fillonte heshtja, andaj nuk ka ndodhur kurfar shkelje e nenit 36 të LZP-së. Gjithashtu ka theksuar se ankues e ka cenuar rëndë nenin 33 pika k) të LPZ-së.

Në përgjigjet në ankesë sa i përket ankesave Anr.474/2021, Anr.475/2021, Anr.482/2021, Anr.484/2021, Anr.485/2021, Anr.490/2021, Anr.491/2021, Anr.492/2021, Anr.493/2021, LVV, pretendon se me nenin 21.3 lidhur me nenin 25.1 të rregullës zgjedhore 09/2013, të KQZ-së, ankesa për thyerje të heshtjes zgjedhore duhet të paraqitet para mbylljes së qendrave të votimit, që do të thotë para orës 19:00. Ankesat e PDK-së janë paraqitur pasi janë mbyllur qendrat e votimit dhe pasi ka kaluar heshtja zgjedhore, andaj janë të pas afatshme. Gjithsesi Vetëvendosje nuk mban përgjegjësi për votues të cilët nuk kanë anëtarë si të dëshmuar, nuk hyn në kategorinë e mbështetësve dhe vepron jashtë mundësive të subjektit të kontrollohen veprimet e tyre. Nuk përjashtohet mundësia që disa nga personat të kenë postuar gjatë heshtjes zgjedhore për të dëmtuar subjektin dhe ecurinë e zgjedhjeve. Andaj i ka propozuar PZAP-së, që të hedhë poshtë ankesat si të pas afatshme, ose ti refuzoj si të pa bazuara.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale – fotografive – CD të bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesat janë të bazuara**

Paneli, ka vlerësuar se ankesat: Anr.471/2021, Anr.472/2021, Anr.473/2021, Anr.474/2021, Anr.475/2021, Anr.479/2021, Anr.480/2021, Anr.481/2021, Anr.482/2021, Anr.483/2021, Anr.484/2021, Anr.485/2021, Anr.486/2021, Anr.487/2021, Anr.489/2021, Anr.490/2021, Anr.491/2021, Anr.492/2021, Anr.493/2021, Anr.494/2021, Anr.495/2021, Anr.496/2021, Anr.497/2021, Anr.498/2021, të cilat për nga përmbajtja janë të njëjta, për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, paraqitës i të gjitha ankesave është subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dhe po ashtu të njëjtat janë paraqitur kundër subjektit të njëjtë politik, Lëvizja Vetëvendosje, prandaj Paneli, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimin të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të*

*trajtohen me një vendim*”, bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga shkresat e lëndës shihet se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dhe kandidatët për deputetet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e këtij subjekti, gjatë heshtjes zgjedhore dhe ditës së votimit në rrjetin e tyre social Facebook, kanë mbajtur aktive postimet edhe gjatë heshtjes zgjedhore, duke bërë fushatë zgjedhore dhe kanë udhëzuar që të votohet subjekti i tyre politik Vetëvendosje, dhe kandidatët e saj, të apostrofuuar në ankesë ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Paneli, konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, ndërmoi hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës, dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, për faktin se në llogaritë e Facebook-ut, ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës, në ditën e heshtjes zgjedhore dhe në ditën e votimit janë hasur reklama politike aktive, në gjithsej 24 shkelje, të cilat promovojnë subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje, dhe kandidatët për deputet nga radhët e këtij subjekti politik, ku me këtë veprim kanë bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Në raport me pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, se pretendimet e palës në përgjigje në ankesë se postimet e kontestuara nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, janë bërë gjatë fushatës zgjedhore dhe se në këtë rast nuk konsiderohet shkelje e heshtjes zgjedhore, këtë pretendim paneli e refuzoi si të pa bazuar. Në rastin konkret kandidatët e cekur në ankesë, në rrjetet e tyre sociale kanë mbajtur postimet aktive edhe gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore duke e përfshirë edhe ditën e votimit, siç konstatohet nga konstatimi zyrtar i PZAP-së i datës 15.02.2021, pas verifikimit të secilës ankesë të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi, andaj në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje të heshtjes zgjedhore.

Në raport me pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje se ankesat e subjektit politik PDK, janë të pas afatshme, këtë pretendim paneli e refuzon si të pa bazuar. Në rastin konkret ankesat nga subjekti politik PDK janë bërë brenda afatit kohor prej 24h, nga verifikimi që ka bërë paneli ka rezultuar që të njëjtat postime të paraqitura në ankesë kanë qenë ende aktive në rrjete sociale Facebook-ut dhe nga kjo rezulton se pretendimi për afatshmëri është i pa bazuar.

Në raport me pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, se postimet janë bërë më herët dhe jo me datë 13 apo 14 Shkurt, dhe se të njëjtat kanë të drejtë të shfaqen nëse janë të postuara më herët, këto pretendim Paneli, i vlerëson si të pa bazuara. Në këtë rast kemi të bëjmë me kandidatët për deputet që kanë postime aktive gjatë datës 13 dhe 14 Shkurt datë e cila është heshtje zgjedhore. Me dispozita ligjore, subjekteve politike apo kandidatëve të tyre iu ndalohe të bëjnë fushatë, në një mënyrë apo tjetër, andaj në këtë rast sponsorizimi i postimeve për shfaqje publike në rrjete sociale edhe për datat 13 dhe 14, është shkelje e heshtjes zgjedhore, prandaj ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) janë pranuar si të bazuara.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par.3 të LZP-së, andaj nuk i mori parasysh pretendimet e paraqitësit të përgjigjes në ankesë, pasi që nga ana e tyre nuk u ofrua ndonjë dëshmi e cila argumenton pretendimet e tyre.

Andaj Paneli, duke iu referuar të cekurave më lart dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se Lëvizja Vetëvendosje, është përgjegjës për veprimet e tija, pasi që me veprimet e lartë cekura ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohe bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marr parasysh rrethanat e rastit siç janë:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar gjoba Lëvizja Vetëvendosje, ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, dhe me këtë rast ka bërë 24 herë e ka thyer heshtjen zgjedhore.
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, vlerëson se gjoba e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me rregullativën ligjore, që cenojnë të drejtën apo lirinë e votimit, në mënyrë që të sigurohet klimë e qetë dhe e përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dëshimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lart cekuar në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.471/2021 më datë 16.02.2021

Kryesuese e Panelit

Milena Derić



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Suprëme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.